



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 111/ 2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nenad Llaziq kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër komisionerëve të vendotimit për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN, Anr.111-2016 e datës 05.12.2016.

ARSYETIM

Më 05 dhjetor 2016, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se ka pasur parregulsi gjatë procesit të votimit, duke shtuar se në QV 0318E- në VV 01R, ka pasur votim me asistencë i cili nuk është evidentuar në Librin e Votimit nga Kryesuesi i VV, gjë që është në kundërshtim me nenin 89 paragrafi 6 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD, për të dëshmuar shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), e informoi lidhur me ankesën Anr.111/2016 të datës 06.12.2016, të parashtruar nga ana e BIRN dhe i kërkoi kopjen e Librit të Votimit për QV 0318E- në VV 01R në afat deri më datë 06.12.2016 në ora 14:00.

PZAP-i, brenda afatit të caktuar pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ në të cilën kishin bashkangjitur kopjet e Librit të Votimit për vendvotimin 0318e/01R, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të Drenasit.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 te Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendës, ka konsideruar se është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore, mirëpo për arsye të ekonomizimit të procedurës dëshminë e dëshmitarës-menaxheres së QV 0318e/01R Antigona Istogu, e ka marrur përmes telefonit duke bërë inqizimin e deklaratës.

ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e BIRN-it, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe në CD-në e ofruar si provë shifet një votuese e gjinisë femrore të cilës i ndihmon një person për të votuar mirëpo në këtë inçizim nuk dëgjohet zëri për të mundur me vertetuar se ka pasur ndonjë vërejtje verbale dhe as reagim fizik nga komisionerët apo vëzhguesit.

Në dëshminë e marrur nga zyrtarët e PZAP-it përmes telefonit zyrtar, nga menaxherja e QV 0318E- në VV 01R Antigona Istogu, thuhet se ajo gjatë ditës së votimit ka pasur të drejtë të hyjë në VV vetëm tre herë si në ora 11:00, 15:00 dhe në orën 19:00 me qëllim që të njoftohet lidhur me procesin e votimit ku gjatë asaj kohe nuk kishte vërejtur ndonjë parregullësi në VV, se ka pasur apo jo votim me asistencë i cili nuk ishte evidentuar në Librin e Votuesve.

Për më tepër, në kopjen e Librit të Votimit e vendvotimit 0318e/01R për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të Drenasit, PZAP-i ka konstatuar se është identifikuar fakti se janë evidentuar të dhënat për katër votues që kanë pasur nevojë për asistim gjatë procesit të votimit ndërsa nga ankesa nuk ka mundur të identifikohet se cili rast ka të bëjë shkeljen e nenit 89 paragrafi 6 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 5 par.7 pikat b) dhe c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 111/2016 më datën 07.12.2016.

**Kryesuesi i Panelit
Nenad Laziq**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.